

13 dhjetor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Kërkohet respektimi i ligjit në qeverisjen lokale

EC Ma Ndryshe sot në Prizren ka organizuar tryezën e diskutimit **“Respektimi i ligjit në qeverisjes lokale”**. Panelistë të tryezës ishin Z. Ian Cliff, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, Z. Ruzhdi Rexha, Nën-kryetar i komunës së Prizrenit, Z. Refki Reshitaj, gazetar i Zërit dhe Znj. Elmedina Baxhaku nga EC Ma Ndryshe. Në pjesën e parë të tryezës, EC Ma Ndryshe ka prezantuar raportin tre-mujor të monitorimit të komunës së Prizrenit, ndërsa kjo është pasuar me paraqitjet e panelistëve dhe diskutimin e hapur. Diskutimi i tryezës u zhvillua rreth temës së respektimit të ligjit në qeverisjen lokale të Prizrenit dhe bashkëpunimin mes aktorëve relevant lokal për arritjen e standardeve të qeverisjes demokratike.

Sipas raportit të prezantuar nga Znj. Baxhaku, monitoruese e EC Ma Ndryshe, të gjeturat kryesore të monitorimit gjatë periudhës shtator – nëntor 2012 tregojnë se: Mos respektimi i kritereve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet; Ekzistojnë praktika të investimeve publike në pronat e kontestuara; Zyrtarët e lartë komunal punojnë edhe në arsim; Komuna e Prizrenit shpërfill kërkesën e MAPL-së për kushtëzimin e qytetarëve për regjistrimin e automjeteve; Pushteti lokal i Prizrenit sfidon autoritetin e Gjykatës Kushtetuese; dhe Rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje paraqet kopje anti-ligjore.

Në bazë të të gjeturave të monitorimit, EC Ma Ndryshe rekomandon: Zbatimin e plotë të UA për Transparencë dhe i legjislacionit në fuqi për rritjen e transparencës; Raportimin më të shpeshtë në media për çështjet që lidhen me përdorimin e buxhetit komunal, zhvillimin ekonomik, përdorimin e pronës komunale, planifikimin urban, investimet, të hyrat komunale; Organizimin e konferencave periodike të shtypit nga zyrtarët për informim; Organizimin e seancave pyetje-përgjigje me publikun e gjerë ose grupet e interesit; Përditësimin e ueb-faqes zyrtare të komunës me të dhëna e dokumente të sakta; dhe Zbatimin e rekomandimeve të mëhershme të EC Ma Ndryshe për transparencë.

Në mënyrë specifike, EC Ma Ndryshe rekomandon që:

- Mos respektimi i kritereve të ndërtimit të ndëshkohet nga institucionet përkatëse,
- Të ndalohen praktikat e investimeve publike në pronat e kontestuara,
- Zyrtarët e lartë komunal që punojnë edhe në arsim të heqin dorë nga angazhimi në dy vende të punës,
- Të anulohet vendimi për kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e borxhit të mbeturinave,
- Të zbatohet në përpikëri aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me rastin Dardania,
- Të shfuqizohet rregullorja për trajtimin e ndërtimeve pa leje me që bëhet fjalë për një kopje anti-ligjore.

Në prezantimet e tyre, panelistët reflektuan mbi të gjeturat e raportit dhe ofruar mendimet e tyre për temën e tryezës. Nën Kryetari i Komunës së Prizrenit Z. Ruzhdi Rexha potencoi rëndësinë e

bashkëpunimit mes qeverisë lokale dhe shoqërisë civile për ngritjen e standardeve të qeverisjes së mirë dhe transparencës në komunën e Prizrenit, ndërsa njëkohësisht ofroi rekomandime konkrete për metodologjinë e monitorimit dhe kërkoi të pasqyrohen edhe të arriturat e qeverisjes lokale në Prizren. Në fjalën e tij, Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë ishte i drejtpërdrejtë në kërkesën e tij për respektimin e ligjit në qeverisjen lokale, duke e potencuar në veçanti domosdoshmërinë për të vepruar në pajtim të plotë me Kushtetutën e Kosovës. Nga këndvështrimi i medias, panelisti i fundit i tryezës Z. Refki Reshitaj nga gazeta Zëri u fokusua në rëndësinë e raportimeve të organizatave monitoruese dhe njëherit kërkoi komunikim më të shpeshtë të zyrtarëve të qeverisë lokale me gazetarët për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrjen lokale.

Raportin e plotë tre mujor të monitorimit dhe analizën mbi respektimin e ligjit në qeverisjen lokale do ta gjeni të bashkëngjitur në këtë komunikatë.

Projekti i monitorimit të transparencës ka filluar së zbtuari në muajin mars 2012 dhe synon ngritjen e nivelit të transparencës lokale në vendimmarrje përmes monitorimit të ekzekutivit të komunës së Prizrenit dhe raportimin për praktikatat e vendimmarrjes lokale. Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" në periudhën mars – gusht 2012 u mbështet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, ndërsa nga muaji shtator e tutje do të vazhdojë së zbtuari me kapacitete të rritura falë përkrahjes financiare të Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj.

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012
përkrahjet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*